

RELACIONI TEKNIK ELEKTRIK

Objekti: “Roma On Market”

ZHVILLUES : BASHKIA GJIROKASTER

**$P_{inst}=14.7kW$
 $P_{kerk}=8.82 kW$
Koef =0.6**

1.-Te pergjithshme

Projekti elektrik eshte bazuar ne:

1. - Kerkesat e investitorit sipas detyres se projektimit
 2. - Projektin arkitektonik dhe mobilimin te dhena nga arkitektura.
 3. - Ne kushtet teknike te projektimit, standartet e Republikes se Shqiperise (KTP, STASH, ENSSH), Ligjet, VKM-te dhe rregulloret ne fuqi si dhe kerkesat e OSHEE.
 - 4.- Standarde, kode dhe rekomandime te organizatave nderkombetare si IEC, EEC, CEN/CENELEC, etc. si dhe standarde e kode disa te vendeve te BE-se si CEI dhe VDE.
- Me specifikisht, ne projektim jane patur parasysht kodet dhe standartet e meposhtem italiane te projektimit pasi pjesa dermuese e materialeve dhe paisjeve jane te importuara nga ky vend.

- o CEI 64-8 Instalimet ne Impiantet rezidenciale
- o CEI 64-50, 64-51, 64-52, 64-53, 64-54, 64-55, 64-56 Guide per kabllimet e integruara (elektrike dhe data)
- o CEI 64-100/1 Guide per infrastrukturen e rrjetave te impianteve eletrike, eletrike per komunikim.
- o CEI 64-51
- o CEI 23-9 aparate komandimi jo automatike
- o CEI 23-51 kuadrot elektrike
- o CEI 23-42 e 23-44 automatet diferenciale dhe magneto termike
- o CEI 17-5 automatet ne TU (230 – 400 Volt)
- o CEI 23-3 automatet
- o CEI 23-50 prizat dhe spinat
- o CEI 34-21 ndricuesit
- o CEI 23-39 tubat dhe aksesoret
- o CEI 20-14, CEI 20-20 e CEI 20-22 kabllot elektrike qe nuk pershkuhen nga zjarri
- o CEI 23-58 rruget e kablllove, trasete, etj
- o CEI 11-35 Udhëzues për zbatimin e kabinave elektrike
- o CEI 11-1 Impiante elektrike per tensionit alternative më të madha se 1 kV.
- o CEI 11-20 Impiante te prodhimit te energjise alternative, grupet e elektrogjen (cat1&2)
- o CEI 11-25, 26 Rrymat e lidhjes se shkurter, ne sistemet trefazore alternative. Llogaritjet.
- o CEI 17-13/1 Siguria e pajisjeve ne tension te ulet (Kuadrot e TU)
- o CEI 81-10/1-4 Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike
- o CEI EN 50173-1 Teknologjia e informacionit- Sistemet e kabllimit te pergjithshem, - Planifikime dhe kriteret e instalimeve ne ambjente te brendeshme
- o IEC 60076-11 Perdorimi i transformatorëve trefazore te thatë .
- o CEI përdoruesit elektrike 64-8/1-2-3-etc

2.- Llogaritja e fuqise

Ne llogaritjen e ngarkesave elektrike te viles kemi marre parasysh kerkesen e klienteve per 14.7 kW fuqi te instaluar. Vlera e koeficientit te fuqise eshte pranuar 0.6. Kjo per arsye se paisjet e sotme elektrike e sigurojne nje koeficient te tille. Ne kete menyre fuqia e kerkuar e pritshme per kete kompleksin do te jete:

$P_{inst}=14.7 \text{ kW}$
 $P_{kerk}=8.82 \text{ kW}$
Koef =0.6

Duke u bazuar tek njekohshmeria e perdorimit te energjise elektrike, per numrin e konsumatoreve koeficienti i njekohshmerise eshte 0.6. Furnizimi I objektit do realizohet nga kabina me e afert.

Kuadrot instalohen ne vendin e caktuar per ta ne planimetri ne lartesine e aksit te mesit +1.6m nga dyshemeja. Gjate instalimit te kihet parasysh montimi i niveluar i tyre dhe rekomandimet e fabrikes prodhuese.

4.- Mbrojtja

Impianti elektrik eshte realizuar me nul te izoluar. Mbrojtja nga renia nen tension dhe mbrojtja e impiantit e paisjeve te tij realizohet nepermjet automateve diferenciale $I_{d}<0.03A$ dhe magnetotermike. Ne dushe vendosen mbrojtje diferenciale e dedikuar me $I_{d}<0.01A$. Ne hartimin e skemes principiale te mbrojtjes jane patur parasysh keto kritere:

- Ndricimi dhe prizat te jene te ndara ne cdo rast.
- Ne rast avarie, selektiviteti te jete i tille qe te mos lejoje nxjerrjen nga puna te te gjitha kateve.

Kuadrot jane kuti prej PVC per automate modulare brenda murit (IP40), te padjegshem.

Fuqia shkycese e automateve magnetotermike (limitaret) qe instalohen ne Panelet e matesve te energjise te jete se paku 6kA per automatet kater polare.

Fuqia e shkycjes se lidhjeve te shkurtra e automateve magnetotermike te panele te ndryshem mund te zvogelohet ne varesi te gjatesise dhe siperfaqes se linjave magjistrale te kollones se furnizimit.

Automatet mbrojtjes dypolare ne qarqet nje fazore mund te kene edhe vetem nje pol me mbrojtje magnetotermike. Kjo lejohet edhe per automatet ne qarqe faze-faze, duke patur parasysh mbrojtjen diferenciale, te pergjithshme apo ne nje faze te vetme te qarkut.

Automatet me pole te plote (automate qe permbajne te gjitha polet e qarkut, perfshi edhe neutrin, te quajtur edhe onnipolare) sigurojne edhe ndarjen e qarkut (ne sistemet TT).

Relacion Teknik – Projekti Elektrik

Automatet me te perdorshem ne instalimet civile e kane karakteristiken e veprimit te tipit C per fuqine dhe B per ndricimin.

5.- Ndricimi

Normat e ndricimit jane marre sipas rekomandimeve UNI projekti 29.00.008.0. Tipi ndricuesit eshte lene i lire te zgjidhet sipas kerkesave individuale te arkitektit. Per efekt llogarites si vlere maksimale eshte pranuar niveli mesatar, rreth 300Lux.

6.- Prizat dhe celsat

Ne ambientet e tregut prizat dhe celesat jane te tipit me module (frute) dhe montohen jashte murit sic parashikohet ne vizatime. Kryesisht prizat jane shuko me tokezim 220V, 16A, sipas specifikimeve ne vizatime ndersa celesat jane 10A, 220V. Detajet e instalimit te tyre jepen ne vizatime.

Ing . elektrik Rozina Koci